



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Nr. 7936/1 Prot

Shkodër, më 28.05.2021

Lënda: Kthim përgjigje ankesës tuaj nr. 7936 prot., datë 24.05.2021

“ALMIRO GURAKUQI” DHE “CARPATHIA ALBANIA” SHPK

Rr. “Muhamet Gjollësia”, pallati 9 katësh, Ap. 2/2, Tiranë

Bashkia Shkodër ka administruar ankesën e BOE “ALMIRO GURAKUQI” PF dhe “CARPATHIA ALBANIA” shpk, me nr. 7936 prot., datë 24.05.2021 që lidhet me procedurën e ankandit me objekt: “Shitje me ankand të aksioneve të klubit të futbollit “Vllaznia” sh.a, në masën 100%“, të zhvilluar me dt. 11.05.2021.

Keni marrë pjesë si ofertues në ankandin e zhvilluar nga Bashkia Shkodër më datë 11.05.2021. Në datë 19.05.2021, Njësia e Ankandit, ka njoftuar me shkresë kandidatët pjesëmarrës mbi rezultatet e vlerësimit të ofertave.

ALMIRO GURAKUQI DHE “CARPATHIA ALBANIA” SHPK, kanë marrë dijeni për skualifikimin e ofertës në datën 19.05.2021.

Në datën 24.05.2021, keni paraqitur ankesë duke dorëzuar formularin përkatës të ankesës, pranë autoritetit shitës, Bashkia Shkodër, protokolluar me nr. 7936 prot., datë 24.05.2021.

Me marjen e ankesës me shkrim, nga ana e titullarit të autoritetit shitës, Kryetari i Bashkisë ka nxjerrë urdhërin për pezullimin e procedurës së ankandit, dhe caktimin e grupit të punës për shqyrtimin e ankesës.

Nga informacioni i siguruar nga Njësia e Ankandit dhe nga ankesa e paraqitur rezulton se jeni skualifikuar për arsyet e mëposhtme:

Për ofertën e paraqitur nga ofertuesi ALMIRO GURAKUQI, P.F nr. NIPTI K31823027R & CARPATHIA ALBANIA shpk nr. NIPTI L41629009A, si bashkim i kandidatëve blerës/ofertues:

- 1) Referuar Dokumentave Standarte të Ankandit pika 4 “Pjesëmarrja dhe kualifikimi” nën pikat 4.7 dhe 4.8 (fq 13 e dsa), si dhe në shtojcën 5 “Kriteret për pjesëmarrje, kualifikim dhe vlerësim i ofertes” (faqe 19 e DSA, paragrafi i fundit), Ofertuesit nuk kanë paraqitur marrëveshje të noterizuar, për krijimin e grupit/bashkimit të kandidatëve blerës në të cilën tregohet përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes, sasia e mallrave konkrete për secilin anëtar. Ky fakt bie në kundërshtim me kërkesat ligjore dhe kërkesat e kualifikimit të përcaktuara në dokumentet e ankandit.*



- 2) Në lidhje me kriterin e përcaktuar në germën f) pika 1 e "Kritereve të veçanta të kualifikimit" subjekti ofertues "Almiro Gurakuqi" NIPTI K31823027R, nuk ka paraqitur dokument për të plotësuar kriterin e vërtetimit që ofertuesi nuk është i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra penale që lidhen me tatim-taksat dhe sigurimet shoqërore.
- Në lidhje me kriterin e përcaktuar në germën f) pika 1 e „Kritereve të veçanta të kualifikimit“ subjekti ofertues "CARPATHIA ALBANIA" shpk nr. NIPTI L41629009A, nuk ka paraqitur dokument për të plotësuar kriterin e vërtetimit që ofertuesi nuk është i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra penale që lidhen me tatim-taksat dhe sigurimet shoqërore.
- 3) Referuar kontatës së bashkëpunimit nr.562. Rep nr. Kol 138, date 03.03.2021, dhe aneks 15/09/2017 rezulton që subjekti Almiro Gurakuqi, p.f ka angazhim jo vetem me sponsorizim por edhe me forma tjera te FC Internacional Tirana, subjekt i cili eshte pjesë e Federatës Shqiptare të Futbollit. Ky fakt bie ndesh me kriterin e ankandit në germën t) pika 1 e Kritereve të veçanta të kualifikimit, "subjekti/subjektet ofertues nuk eshte ortak, i angazhuar per nje klub tjetër futbollit, anetar i federates shqiptare te futbollit, pasi kjo demton konkurencen sportive sipas ligjit ne ligen shqiptare te futbollit".
- a. Nje fakt i tillë përbën shkak ligjor për skualifikimin e subjektit ofertues.
- 4) Sa i takon permbushjes se kriterit te percaktuar ne germen s) pika 1 e „Kritereve te vecanta te kualifikimit“ subjekti ofertues ka prezantuar subjekti ka paraqitur listen e stafit qe do te angazhoje:Por mungojne deklaratat e angazhimit personal te stafit i cili pritet te angazhohet duke mos permbushur kriterin e percaktuar ne germen s) te pikes 1 te DSA.
- 5) Oferta e paraqitur nga BOE "Almir Gurakuqi" PF & "Carpathia Albania" shpk, me vlere 45.833.333 leke eshte ne kundershtrim me piken 2, te nenit 37 te LAP: 2. Ofertat renditen duke filluar me çmimet më të larta dhe deri në ato të barabarta me çmimin fillestar minimal të shitjes, si dhe me germen "ç" të pikës 5.3 të VKM Nr.1719, datë 17.12.2008 "Për miratimin e rregullave të ankandit publik" te ndryshuar: "...Bazuar në ofertat e pranuar, njësia e ankandit harton klasifikimin përfundimtar duke renditur ofertat me çmimet më të larta deri në ato të barabarta me çmimin fillestar minimal të shitjes dhe e komunikon atë në kohën e përcaktuar".Ne piken 2 te nenit 142 te ligjit Nr. 92/2014 "Per tatimin mbi vleren e shtuar ne RSH", percaktohet se:2.Në faturën e lëshuar nga organizatori i shitjes me ankand për blerësin nuk duhet të llogaritet apo të pasqyrohet e ndarë vlera e TVSH-së. Në çdo faturë të lëshuar që i nënshtrohet shitjes me ankand organizatori i shitjes në ankand duhet të shënojë: "Shitje që i nënshtrohet regjimit të shitjes me ankand".
- a. Ne rastin konkret oferta e bashkimit të mësipërm të operatorëve ekonomike eshte me ulet se vlera fillestare e ankandit dhe per kete arsye ajo duhet te skualifikohet si oferte në kundërshtim me ligjin. Në procedurat e ankandit autoriteti kontraktor kur përllogarit vlerën e ankandit nuk shprehet me TVSH apo pa TVSH. Vlera fillestare e ankandit perben vleren totale te pagueshme, per kete arsye BOE duhet te skualifikohet pasi ka paraqitur oferten ne kundershtrim me ate qe percaktojne aktet ligjore ne rastin e procedurave te



- ankandit. Ofertimi duke përfshirë dhe vlerën e TVSH, vjen ndesh me pikat 3.11-3.13(fq 11) të Dokumentave të Ankandit, në të cilën përcaktohet se:
- b. Llogaritja e çmimit 3.11 Kandidati blerës duhet të plotësojë Formularin e Ofertës bashkangjitur me këto DA, duke përcaktuar një listë të hollësishme çmimesh që përbejnë çmimin e plote.
 - c. 3.11 Të gjitha çmimet duhet të kuotohen në Monedhën Shqiptare (Lek), duke përfshirë edhe tatimet që zbatohen, por pa përfshirë TVSH. Nëse çmimet kuotohen në një monedhë të huaj, atëherë ato duhet të kthehen në Lekë Shqiptare dhe kursi i shkëmbimit duhet të jetë ai i fiksuar nga Banka Qendrore e Shqipërisë në ditën kur publikohet njoftimi i kontratës dhe duhet të ruhet në atë kurs shkëmbimi deri në skadimin e periudhës së vlefshmërisë së ofertës.
 - d. 3.12 Ofertuesi duhet të shënojë Programin e Çmimit çmimet totale të ofertës pa TVSH. Vlera e TVSH, kur aplikohet, i shtohet çmimit të dhënë dhe përbën vlerën totale të ofertës.
 - e. 3.13 Çmimet e dhëna nga Ofertuesi duhet të jenë të fiksuar për gjatë ekzekutimit të kontratës dhe nuk duhet t'i nënshtrohen asnjë ndryshimi në asnjë aspekt. Oferta e paraqitur me çmim të ndryshueshëm, dhe që nuk është në përputhje me këtë paragraf, do të refuzohet nga Autoriteti Kontraktors i papranueshëm.

1. Lidhur me pretendimin e parë të ankuesit vërejmë se:

1. Bashkimi i Operatorëve Ekonomik, ALMIRO GURAKUQI DHE “CARPATHIA ALBANIA” SHPK, argumenton se:

“Në lidhje me këtë pikë BOE ka paraqitur prokurën e posaçme me nr. 1573 rep., nr. 145/I kol, në të cilën ka përcaktuar përfaqësuesin e grupit. Në paragrafin e dytë të prokurës, shprehet qartë që është krijuar bashkimi i sipërpermendur, duke cituar që BOE është krijuar nga kontrata me nr. Rep .572 dhe nr. Kol. 144. Dokumenti i paraqitur është miratuar dhe nënshkruar nga të gjitha palët. Dokumenti i paraqitur si dhe kontrata për të cilën i referohet ky dokument janë lehtësisht të verifikueshme në sistemin elektronik të noterisë. Mos dorëzimi i kontratës së krijimit të BOE vjen si pasojë e gabimit njerezor i cili përbën një devjim minor dhe nuk ndikon apo ndryshon në kushtet dhe kërkesat e përcaktuara në DSA.....”

“Për sa më sipër në ditën e zhvillimit të ankandit është paraqitur edhe sigurimi i ofertës si BOE.

Dorëzimi i kontratës noteriale të BOE nuk është kriter i përcaktuar as tek kriteret e pergjithshme as te kriteret e posaçme, dhe skualifikimi jonë nga gara me pretendimin se nuk kemi dorëzuar këtë kontratë është absurd dhe i pabazuar.”

Autoritetit Shites ju sqaron se:

- a) Referuar Dokumentave Standarte të Ankandit pika 4 “Pjesëmarrja dhe kualifikimi” nën pikat 4.7 dhe 4.8 (fq 13 e dsa), kerkohet qartësisht se: “Para dorëzimit të ofertes, grupi duhet të krijohet zyrtarisht me anë të një marreveshje të noterizuar, në të cilën te



tregohet perfaqesuesi i grupit, perqindja e pjesmarrjes dhe sasia e mallrave konkrete per seicilin anëtarë, si dhe autorizimi/prokurëen per perfaqesimin e anetareve te grupit, si per dorezimin e ofertes ashtu edhe per lidhjen e kontrates ne rast shpalljes fituesi”

- b) Po ashtu edhe në shtojcën 5. “**Kriteret për pjesëmarrje, kualifikim dhe vlerësim i ofertes**” (faqe 19 e dsa , paragrafi i fundit) përcaktohet qartesisht se: “Një bashkim operatorësh ekonomik futet ne ankand me nje marreveshje, ku percaktohet paraprakisht % e secilit, kush është lideri, raportet per faturimin dhe te tjera”
- c) Në ankimin tuaj ju shpreheni se “Mos dorezimi i kontratës së krijimit të BOE vjen si pasojë e gabimit njerezor i cili përbën nje devjim minor dhe nuk ndikon apo ndryshon ne kushtet dhe kerkesat e përcaktuara në DSA...! Mosdorëzimi i kontratës së krijimit të BOE, që perben dokumentin thelbesor te konstituimit te BOE, nuk konsiderohet “minor”, pasi përbën dokumentin themeltar mbi bazën e të cilit është krijuar ky bashkim.
- d) Referuar Procesverbalit të hapjes dhe shqyrtimit te ofertave te nënshkruar nga të gjithë anëtarët e Njësisë së Ankandit dhe nga të gjithë përfaqësuesit e ofertuesve, pra edhe nga ana juaj, konstatohet që nuk është e listuar Marrëveshja e Bashkëpunimit mes bashkimit të opertorëve,pra që kjo marrëveshje nuk është dorëzuar bashkë me dokumentat e ankandit.
- e) Sipas pikës 3, nenit 36 të ligjit, Nr.9874, datë 14.2.2008 “**Per ankandin publik**”, ndryshuar përcaktohet: “Autoriteti shitës, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson se oferta është e vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e ankandit dhe në dokumentet e ankandit.”

Në përfudim:

Mungesa e një akti të tillë përbën shkak të ligjshëm për skualifikimin e ofertës tuaj.

2. Bashkimi i Operatorëve Ekonomik, “ALMIRO GURAKUQI” PERSON FIZIK DHE “CARPATHIA ALBANIA” SHPK, argumenton se:

“Ju bëjmë me dije se subjekti ofertues “Almiro Gurakuqi” P.F. me nr NIPT K31823027R si dhe CARPATHIA ALBANIA shpk nr.NIPTI L41629009A kanë paraqitur vërtetim të marrë nga gjykata me anë të cilit vërteton faktin se është i padënuar asnjeherë nga gjykata shqiptare. Ky vertetim eshte i vlefshem per te gjitha llojet e veprave penale, perfshirë edhe ato të tatim taksave apo në lidhje me sigurimet shoqërore. Nëse ky subjekt do të ishte i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, për çfarëdolloj vepre penale në vërtetimin e depozituar do ishte shkruar i dënuar dhe jo i padënuar.”

Autoritetit Shites ju sqaron se:

- a) Nuk është në kompetencën e gjykatave shqiptare të lëshojnë vërtetime për personat fizik dhe juridik nëse janë “të dënuar” apo të “padënuar”. Vërtetimet nga gjykata shërbejnë për të provuar ekzistencën apo mos ekzistencën e proceseve gjyqësore për të cilat gjykatat nuk kanë marrë vendime të formës së prerë.
- b) Sipas ligjit Nr. 9614, datë 21.9.2006 “**Per çertifikatat elektronike të gjendjes gjyqësore**” organi kompetent per leshimin e vërtetimit nese administratori i shoqërisë apo personi juridik, shoqëria tregtare ka qenë e denuar, janë Zyrat e Gjendjes Gjyqësore



neën vartesine e Ministrise se Drejtesisë. Aplikimi kryhet nëpërmjet shërbimit e-albania si dhe pranë Drejtorisë së Burgjeve në Tiranë.

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur mungon Vertetimi/Deshmia Penalitetit se administratorët e këtij BOE janë “të padënuar” si dhe vertetimi se subjektet, personat juridik që përbëjnë këtë BOE nuk kanë procese gjyqësore të hapura në Gjykatat përkatëse.

- c) Për përmbushjen e këtij kriteri shumë të rëndësishëm në zbatim dhe përmbushje të kriterëve specifike të percaktuara nga DSA, ky BOE nuk rezulton të kete kërkuar informacion përpara dorëzimit të ofertes prandaj mospërmbushja e tij përbën shkak ligjor për skualifikimin e ofertës tuaj.

3. Bashkimi i Operatorëve Ekonomik, ALMIRO GURAKUQI DHE “CARPATHIA ALBANIA” SHPK, argumenton se:

“Në rastin e kontratës së paraqitur nga ana jonë, të titulluar:”Kontrate sponsorizim bashkpunim dhe partnertet në fushën e sportit” ajo nuk na jep neve të drejten për të qene ortak (pronar) në FC International Tirana”, qënia ortak në bazë të një kontrate sponsorizimi përjashtohen në mënyrë eksplicite nga vetë ligji nr. 7892, dt. 21.12.1994 “Për sponsorizimet”, i ndryshuar i cili që në nenin 1 të tij, sanksionon: “Ky ligj siguron mbështetjen në ndihma financiare dhe materiale të quajtura në vijim, sponsorizime të veprimtarive sociale, Publike ku përfshihen veprimtari kulturore, artistike, sportive educative, arsimore ...”

Nga ana tjetër, marrëdhënia e ortakërisë rregullohen nga ligji me nr. 9901, dt. 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar i cili rregullon ortakërinë në një nga format që mund të shfaqet në shoqëri tregtare si: ... “

Kontrata e mësipërme nuk ka asnjë reference që të na bëjë ortak me FC Internacional Tirana, pasi nuk ka asnjë reference në një nga format e cituara më sipër të shoqërive. Ky interpretim i Bashkisë Shkodër është sa i gabuar ashtu edhe i pambështetur në prova dhe në ligj. Për sa më sipër subjekti ynë nuk ndodhet në kushtet e një ortakut të angazhuar për një klub tjetër futbollit. Gjithashtu, në plotësimin e dokumentacionit lidhur me angazhimet me klubet e tjera, kemi depozituar deklaratat e të dy kompanive ku kemi specifikuar që nuk jemi as ortakë e as të angazhuar për një klub tjetër futbollit anëtare e FSHS-së dhe as të ndonjë federate tjetër.

Autoriteti shites ju sqaron se:

- a) Sipas vleresimit nuk është konstatuar formë ortakërie por një angazhim i vazhdueshëm i subjektit “Almiro Gurakuqi”, me klube anëtare të FSHFse, të cilat konkurojnë me ekipet e akademisë së Klubit të Futbollit “Vllaznia”, ndonëse në kundërshtim me përcaktimin në DSA (të ndryshuara), asnjëra prej subjekteve të këtij BOE nuk e ka si pjesë të veprimtarisë së saj në ekstraktin historik mbështetjen e aktiviteteve sportive.
- b) Kontrata date 01/08/2017 dhe aneks 15/09/2017 dhe Kontrata 03/03/2021 tregojnë qartësisht lidhje me angazhim të vazhdueshëm, jo vetëm me sponsorizim, por edhe me forma tjera të FC Internacional Tirana, e cila ka ekipe që konkurojnë në të gjitha grupmoshat me ekipet e Akademisë Futbollit “Vllaznia”. Kjo bie ndesh me kriterin e tenderit që “.....subjekti/subjektet ofertues nuk është ortak, i angazhuar për një klub

tjetër futbollit, anëtar i federatës shqiptare të futbollit, pasi kjo dëmton konkurrencën sipas ligjit në ligën shqiptare të futbollit...”

- c) Në mënyrë specifike, kontrata e lidhur me datë 03/03/2021 “Kontratë sponsorizim bashkëpunim dhe partneritet ne fushen e sportit” qe e mban te angazhuar ofertuesin me FC Internacional Tirana deri ne vitin 01.08.2022 bie ndesh edhe me deklaraten e subjektit ofertues qe subjekti/subjektet ofertues nuk është ortak, i angazhuar për një klub tjetër futbollit, anëtar i federatës shqiptare të futbollit, pasi kjo dëmton konkurrencën sipas ligjit në ligën shqiptare të futbollit. (shih linkun ku provohet se FC Internacional Tirana është anëtare e FSHF <https://fshf.org/asambleja/> (shih linkun ku FC Internacional Tirana është një grup me U-19, U-17, U-15 e K.F Vllaznia Kupa e Shqiperise U-19 - FSHF U-17 Superiore Grupi A - FSHF U-15 Superiore Grupi A - FSHF).
- d) Ofertuesi nëpërmjet kësaj kontratë angazhohet në citojmë “bashkpunim”, “Partneritet”, duke dhënë jo vetëm mbështetje financiare, por edhe teknike me synim konsolidimin e rezultateve te ekipeve te moshave te Akademise “FC Internacional Tirana” sh.p.k.
- e) Nëpërmjet kësaj kontrate sponsori “Almiro Gurakuqi” merr përsipër detyrimet e mëposhtme:

- Përgatitjen e një plani emergjence dhe te treguesve të performances që mundesojnë motivimin e personelit Teknik dhe te lojtareve per permiresimin e performances se ekipit.
- Mbështetje për ndertimin e sistemit te menaxhimit te ekipit te futbollit bazuar ne indicator dhe tregues te matshem duke patur ne konsiderate
- Stabilizimin e veshtiresive tekniko financiare
- Konsolidimin e ecurise dhe vijimsi
- Menaxhimi cilesor dhe i pergjegjshem i shoqerise
- Mbeshtetje teknike per strategjine afatgjate dhe zhvillimin e veprimtarise sportive te futbollit dhe ristrukturimin e ekipit FC.Internacional Tirana perfshire dhe riorganizimin dhe efektivitetin e funksionimit te akademise se futbollit dhe diversifikimin e veprimtarise se shoqerise ne funksion te garantimit te cilesise sportive, te pritshme nga publiku sportdashes dhe me gjere, si dhe permiresimin e qendrueshmerise financiare te saj.
- Rekomandime per strukturat e shoqerise, pertreguesit e performances se personelit administrative dhe Teknik, ne periudhen afat-shkurter dhe afat-mesme
- Dhënia e mbështetjes financiare në varësi të kapaciteteve të sponsorit Almiro Gurakuqi PF në formën e sponsorizimeve pa përjashtuar edhe financimin ne formen e huaperdorjes (hua pa interes) per pjesen tjetër që mund kërkohet apo ofrohet, sipas legjislacionit ne fuqi.
- Disburisimi i mbështetjes financiare qofte ne formen e sponsorizimit apo te huaperdorejes sipas legjislacionit ne fuqi vetem per qellime te paracaktuara dhe te pranuar prej te gjithe partnereve ne kete marreveshje, te cilat perfshijne, por nuk kufizohen ne pagesat per pagat e lojtareve, trainereve te ekipit te pare dhe te akademise, personelit te rendesishem administrative dhe shpenzimeve te tjera qe lidhen me organizimin dhe zhvillimin e stervitjes se ekipit dhe te ndeshjeve te tij te planifikuara, sipas legjislacionit ne fuqi.
- Heqjen dore nga pretendimi per njohjen e shumes faktike te financimit si detyrime nga ana e sponsorit “Almiro Gurakuqi” në rast te zgjidhjes apo ndërprerjes së kësaj marrëveshje në mënyrë te njëanshme nga ana e sponsorit.

Në përfundim:

- a) konstatohet qartë dhe lehtësisht që subjekti ofertues ka angazhim me një klub anetarë të FSHF-së, në kundërshtim me atë që deklaron.
- b) Për më tepër rezulton se deklarata e nënshkruar nga vetë subjekti Almiro Gurakuqi se “...nuk jam as ortak dhe as i angazhuar për një klub tjetër futbollit, anetare i federatës shqiptare të futbollit dhe as ndonjë federatë tjetër”, sipas dokumentacionit të paraqitur dhe argumentave të mësipërm, nuk qëndron.

4. Bashkimi i Operatorëve Ekonomik, ALMIRO GURAKUQI DHE “CARPATHIA ALBANIA” SHPK, argumenton se:

“Subjekti ofertues bashkangjitur listes së stafit që do të angazhojë (në rast se do të shpallet fitues) gjithashtu ka paraqitur edhe CV të secilit pjestarë të stafit, të cilët tregojnë kualifikimin e tyre, gjithashtu këto persona tashmë të angazhuar janë edhe pjesë e grupeve të punës, ky kriter jo vetëm që është i përmbushur, por për më tepër i kalon kufijt e një deklarate të thjeshtë për premtim angazhim, duke u angazhuar plotësisht që në këtë fazë. Ky kriter i veçantë përmban listën e stafit që do të angazhohet, listë e cila është depozituar përmban CV e secilit anëtar të stafit të cilat gjithashtu janë dorëzuar dhe nuk mund të prezumohet si kriter i papërmbushur nga ana jonë dhe të përbëjë shkak për skualifikim, mungesa e një deklaratë gadishmërie nga e cila nuk varet asgjë.

Ky kriter jemi të ndërgjegjshëm që nga tre kërkesat që ka janë plotësuar vetëm dy, por kjo përbën një devijim minor nga kërkesat e përcaktuara në DSA.

Autoriteti shites sqaron se:

- a) Deklarata e angazhimit të personave të cilët do të jenë pjesë e stafit është në kriterin domosdoshëm që shpreh vullnetin e personave pjesë e stafit të cilët do të marrin përgjegjësi. Vullneti shprehet nëpërmjet deklaratimit personal të nënshkruar nga vetë personi. Dorëzimi i CV-ve të personave në fjalë nuk mund të konsiderohet kurrësi shprehje vullnetit përse kohë nuk ka një deklaratë të nënshkruara nga vetë personat.
- b) Nga ana e jone si Autoritet Shites nuk kemi marrë nga ana e juaj asnjë ankese për heqjen e këtij kriteri, prandaj përmbushja e tij nuk është e justifikueshme duke mos i dhënë mundësinë Autoritetit Shites të vlerësojë mbi gadishmerinë e këtyre personave për të qenë të gatshëm dhe të lirë nga angazhimet e tyre personale, për të zbatuar planin e paraqitur nga ana e juaj.
- c) Gjithashtu ju e pranoni vetë faktin që nga tre kërkesat tona, ju keni plotësuar vetëm dy, dmth keni paraqitur listën e stafit që do angazhoni dhe CV e tyre, ndërkohë mungojnë Deklaratat e angazhimit të anëtarëve të stafit tuaj.

Në përfundim:

Mos plotësimi i këtij kriteri sipas pikës 3, nenit 36 të ligjit, Nr. 9874, datë 14.2.2008 “Për ankandin publik”, ndryshuar, perben shkak për skualifikimin e ofertës tuaj.

5. Bashkimi i Operatorëve Ekonomik, ALMIRO GURAKUQI” DHE “CARPATHIA ALBANIA” SHPK, argumenton se:

“Të detyruar në zbatimin e plotesimin e këtij formulari BOE Almir Gurakuqi PF & Carpathia Albania shpk, vleres totale 55.000.000 lek te ofertes e cila permban te gjitha detyrimet fiskale, i ka hequr pjesen e TVSH-se per plotesimin e pikes 4 te formularit te ofertes e cila eshte pjese perberese e dokumentave te ankandit te cilat jane te miratuara sipas nenit 26 te LAP”

SEKRETAT
BASHKIA SHKODË

Autoriteti shites ju sqaron se:

- a) Ne piken 2 të nenit 142 te ligjit Nr. 92/2014 “Per tatimin mbi vleren e shtuar ne RSH”, percaktohet se: *“Në faturën e lëshuar nga organizatori i shitjes me ankand për blerësin nuk duhet të llogaritet apo të pasqyrohet e ndarë vlera e TVSH-së. Në çdo faturë të lëshuar që i nënshtrohet shitjes me ankand organizatori i shitjes në ankand duhet të shënojë: “Shitje që i nënshtrohet regjimit të shitjes me ankand”.*
- b) Në procedurat e ankandit autoriteti kontraktor kur perlllogarit vleren e ankandit mban parasysh vleren fillestare te ankandit e cila perben vleren totale te pagueshme, qe ne kete rast eshte vlera pa TVSH. Prandaj si e tille oferta e paraqitur nga BOE “Almir Gurakuqi” PF & “Carpathia Albania” shpk, me vlerë 45.833.333 leke është në kundërshtim me piken 2, te nenit 37 te LAP duke qënë se është më e ulët se vlera fillestare e ankandit. Përsa mësipër oferta e juaj është skualifikuar si ofertë në kundërshtim me ligjin.

Në përfundim:

Autoriteti Shites ka vlerësuar dhe vendosur qe oferta e juaj të skualifikohet si nje oferte e cila nuk ploteson kriteret ligjore dhe ato te percaktuara nepermjet Dokumentave Standarte te Ankandit.

Për sa më sipër, në ankimin tuaj ju keni kërkuar:

1. Anullimin e procedurave të ankandit, të zhvilluar deri në këtë fazë dhe rifillimin nga e para e kësaj procedure.
2. Rishikimi i dokumentacionit të subjekteve të tjera ofertuese, pasi dyshojm që ato kanë probleme në dokumentacionin e paraqitur.
3. Hartimi i kriterëve të reja, në mënyrë që kriteret e reja të jenë jo diskriminuese, të bëjnë një trajtim të barabartë të pjesëmarrësve në mënyrë që të zhvillohet një garë e barabartë për të gjitha subjektet ofertuese.

Autoriteti shites ju sqaron se:

1. Në lidhje me kërkesën për anulimin e procedurës së ankandit në këtë fazë, Autoritetit Shitës, Bashkisë Shkodër kjo kërkesë i rezulton e pabazuar në ligj dhe prova dhe e pa arguemtuar nga ana juaj. Ju nuk keni paraqitur qofte edhe nje shkelje ligjore nga ato qe perbejne shkak ligjor per anulimin e procedures, përveç faktit që subjekti ofertues pranon me dijeni dhe ndërgjegje të plotë mangesitë në dokumentacion dhe përmbushjen e kriterëve ligjore.



2. Autoriteti shites Bashkia Shkodër, që nga fillimi i procedurës së Ankandit dhe në vazhdimësi, ka realizuar një process ligjor transparent dhe të hapur për t'i dhënë përgjigje çdo ankimi apo shkelje të pretenduar ligjore.

Në çdo rast dhe në përputhje me kriteret ligjore nëse subjekti juaj ka dyshime të arsyeshme dhe te bazuara ne indicie të besueshme për plotesimin e një kriteri të caktuar ligjor nga subjektet e tjera pjesmarrëse, jemi të hapur që të shqyrtojmë apo rishqyrtojmë plotësimin e çdo kriteri.

Barra e provës për të argumetuar dyshimet tuaja mbetet mbi ju, dhe ju si ankimues nuk keni paraqitur asnje fakt konkret apo prove, prandaj pretendimi juaj nuk mund të merret parasys.

3. Të gjitha kriteret e përcaktuara në dokumentet standarde të këtij ankandi janë vendosur duke respektuar me përpikmëri detyrimet e përcaktuara sipas kuadrit ligjor në fuqi dhe të drejtës që i takon Autoritetit Shitës për të bërë përzgjedhjen më të mirë në kualifikimin e atyre subjekteve të cilet krijojnë besueshmeri dhe qëndrueshmërinë e nevojshme për arritjen e objektivave financiare, sportive dhe publike.

Autoriteti shites ju sqaron se kjo kerkese bie ne kundershtim te hapur me procedurat dhe kriteret ligjore te percaktuara ne ligjin nr. 9874 dale 14.02.2008 "Per Ankandin Publik", i ndryshuar, VKM Nr.1719, datë 17.12.2008 "*Per miratimin e rregullave te ankandit publik*", i ndryshuar, prandaj ne kete faze te procesit nje kerkese e tille eshte absolutisht e pavend dhe si e tille nuk mund te konsiderohet. Kjo bazuar në parashikimet ligjore të nenit 27 të ligjit "Për ankandin publik, i ndryshuar "Sqarimet dhe ndryshimet në dokumentat e ankandit", ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për objektin që do të shitet me ankand nga autoriteti shitës, i cili duhet ti përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumentave të ankandit, të bërë nga çdo operator ekonomik me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave."

Ju në një fazë të tillë keni ushtruar të drejtën tuaj të ankimit përmes ankesës me nr. 3352/2 prot., datë 04.03.2021 të paraqitur nga subjekti personi fizik "Almiro Gurakuqi" dhe z. Tedi Mula (përfaqësues me Prokurën e Posaçme nr. rep 505, nr. kol. 120/3, dt. 24.02.2021) ankesë e cila është trajtuar nga Autoritetit Shitës dhe keni marrë përgjigje.

Në përfundim të shqyrtimit, bazuar në ligjin nr. 9874 dale 14.02.2008 "Per Ankandin Publik", i ndryshuar, VKM nr.1719, datë 17.12.2008 "Per miratimin e rregullave te ankandit publik" ndryshuar, **ankesa e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë "Almiro Gurakuqi" person fizik dhe "Carpathia" sh.p.k** nuk qëndron dhe në këto kushte, nuk merret parasys.

KRYETAR
Voltana Ademi